

PRESS RELEASE



25 nëntor 2024

UNDP publikoi Analizën e Pulsit Publik mbi Efektet e Liberalizimit të Vizave

Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë publikoi sot Analizën e Pulsit Publik mbi Efektet e Liberalizimit të Vizave në Migrim në një tryezë të rrumbullakët me Dudley Tarlton, Zëvendës Përfaqësues i Përhershëm i UNDP-së, Alex Albertine, Drejtor i Zyrës për Rritje Ekonomike, USAID, Mrika Kotorri, Eksperte e Migrimin, Sihana Bejtullahu, Bashkëdrejtore Ekzekutive në GERMIN dhe përfaqësues nga akademira, OSHC-të dhe UNDP.

Që nga 1 janari 2024, Kosovës iu lejua udhëtimi pa viza në BE. Analiza shqyrton ndikimin e liberalizimit të vizave në ekonomi dhe hulumton demografinë e atyre që janë larguar që nga janari 2024, duke përfshirë gjininë, përkatësinë etnike, moshën, arsimin, profesionin, nivelin e të ardhurave dhe vendbanimin, si dhe pritshmëritë dhe planet e tyre.

Disa nga gjetjet kryesore nga sondazhi përfshijë:

- Shumica e të anketuarve (95.3 përqind) e lidhin saktë liberalizimin e vizave Shengen të BE-së me aftësinë për të udhëtuar pa vizë, ndërsa vetëm një përqindje e vogël gabimisht besojnë se kjo u jep të drejtën për të punuar kudo në BE (2.5%) ose qëndrim të përhershëm (1.5 përqind).
- Ndërgjegjësimi për kufizimet e liberalizimit të vizave, veçanërisht se ai lejon qëndrime të shkurtra, por jo punësim, ndryshon ndjeshëm sipas përkatësisë etnike. Shqiptarët e Kosovës tregojnë një nivel më të lartë të vetëdijes së plotë (75.5 përqind) krahasuar me serbët e Kosovës (25.0 përqind), ku komunitetet e tjera të Kosovës janë në mes.
- Efektet më të parashikuara të liberalizimit të vizave është pritshmëria e rritjes së mundësive për punë dhe biznes, ku 54.3 përqind e të anketuarve e kanë theksuar këtë si përfitim kyç.
- Një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve (47.3 përqind) gjithashtu parashikojnë rritjen e shkëmbimit kulturor dhe turizmit si një përfitim të madh të liberalizimit të vizave. Për më tepër, 33.8 përqind presin përmirësim të shkëmbimit arsimor, duke treguar një njohje të gjerë të potencialit për ndërveprim më të madh kulturor dhe arsimor.
- Shumica e të anketuarve shprehin optimizëm për ndikimin pozitiv të liberalizimit të vizave në ekonomi. Konkretisht, 72.7 përqind parashikojnë një efekt pozitiv, nga të cilët 26.4 përqind presin të jetë shumë pozitiv. Kjo reflekton një besim të fortë se liberalizimi i

PRESS RELEASE



vizave do të kontribuojë në rritjen ekonomike, veçanërisht në zonat urbane ku 76.9 përqind e shohin ndikimin shumë pozitivisht dhe pozitivisht.

- Shumica e të anketuarve (92.1 përqind) besojnë se liberalizimi i vizave ka të ngjarë të çojë në më shumë investime të huaja direkte.
- Mbi gjysma e të anketuarve (52.2 përqind) janë të kënaqur me mundësitë e tyre aktuale profesionale.
- Të anketuarit theksojnë gjithashtu përfitimet e mundshme për sektorin e turizmit, me 35.0 përqind që besojnë se turizmi do të përfitojë ndjeshëm nga liberalizimi i vizave, ndërsa 40.3 përqind mendojnë se do të ketë një ndikim të moderuar.
- Ndër të anketuarit më të rinj (18-24), 35.6 përqind ose mendojnë ose kanë gjasa të largohen jashtë vendit. Përkundrazi, kjo konsideratë zvogëlohet ndjeshëm tek grupmoshat më të vjetra, me vetëm 5,0 për qind e atyre të moshës 45-54 dhe 3,0 për qind e atyre të moshës 55-64 vjeç që mendojnë për një lëvizje.

Disa nga gjetjet kryesore nga diskutimet e fokus grupeve me bizneset dhe institucionet janë:

- Sektorët e shëndetësisë dhe arsimit janë ndikuar kryesisht nga emigrimi i profesionistëve dhe infermierëve më të rinj, të cilët po kërkojnë gjithnjë e më shumë mundësi jashtë vendit për paga dhe kushte më të mira pune.
- Sektori i kujdesit shëndetësor po përballet me mungesën e punëtorëve të kualifikuar, veçanërisht në kujdesin dytësor dhe terciar. Kjo ka çuar në radhë të gjata, shërbime të vonuara dhe një mbështetje të profesionistët më të vjetër që së shpejti mund të dalin në pension.
- Sektori i energjisë ka përjetuar emigrim të fuqisë punëtore, veçanërisht në mesin e stafit teknik dhe nënkontraktorëve, sidomos në industrinë e energjisë solare.
- Kushtet e këqija të punës, papunësia, paga e ulët dhe mundësitë e kufizuara të zhvillimit profesional janë faktorët kryesorë nxitës për emigracionin në të gjithë sektorët.
- Pagat më të mira, ngritja në karrierë dhe mjediset e përmirësuara të punës jashtë vendit janë faktorë të fortë tërheqës.
- Liberalizimi i vizave ka lehtësuar lëvizshmëri më të madhe profesionale, por gjithashtu ka kontribuar në largim të talenteve. Përfaqësuesit institucionalë janë të shqetësuar se ikja e vazhdueshme e trurit (brain drain) mund të dëmtojë tërheqjen për investitorët e huaj duke ulur stabilitetin dhe cilësinë e shërbimit.

PRESS RELEASE



Analiza e Pulsit Publik nxjerr në pah perceptimet e 1,306 pjesëmarrësve në shtatë rajone, duke reflektuar diversitetin gjinor dhe etnik. Për më tepër, analiza përfshin gjetjet nga gjashtë diskutime në fokus grupe me përfaqësues nga institucionet lokale dhe qendrore, duke përfshirë bizneset për të vlerësuar mundësinë e ikjes së trurit, strategjitë për zbutjen dhe ndikimin e emigrimit të fuqisë punëtore në sektorë kyç si shëndetësia, arsimi, energjia, dhe teknologjia e komunikimit të informacionit.

Të dhënat shitesë të marra nga ky sondazh dhe nga sondazhet e mëparshme do të vihen në dispozicion në Platformën e Vizualizimit të të Dhënave të Pulsit Publik dhe ASKData: <https://bit.ly/44GqPyi>

Projekti Public Pulse, i cili filloi në vitin 2002, financohet dhe mbështetet nga populli amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) në Kosovë.

Për më shumë informata, ju lutemi të kontaktoni:

Burbuqe Dobranja, zyrtare për komunikim pranë UNDP-së

Tel: (038) 249 066 lok. 410; mobil: 049 720 800; email: burbuqe.dobranja@undp.org

Danijela Mitić, zyrtare për komunikim pranë UNDP-së

Tel: (038) 249 066 lok. 412; mobil: 049 720 824 e-mail: danijela.mitic@undp.org